



UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
FAKULTETI I EKONOMISË DHE AGROBIZNESIT
DEPARTAMENTI ...



TEMA E DIPLOMES

BACHELOR

Titulli i temës së diplomës: Tema të shkruhet brenda
kësaj kornize

Përgatiti

Emër MBIEMËR

Udhëhoqi

Emër MBIEMËR

Si pjesë e përmbushjes së detyrimeve për mbylljen e studimeve të nivelit Masterit Shkencor

Tiranë, më data muaji viti

Autorësia

© Copyright, Emër MBIEMËR, viti

Përmbajtja e këtij punimi është krejtësisht autentike. I jap Universitetit Bujqësor të Tiranës të drejtën e përdorimit të pjesshëm apo të plotë të tij.

Unë, i nënshkruari Emër MBIEMËR, deklaroj se kjo temë përfaqëson punimin tim origjinal, përveç rasteve të citimeve dhe referencave, si dhe nuk është përdorur më parë në këtë universitet apo në universitete të tjera.

Mendimet e shprehura në këtë temë janë të autorit dhe nuk përfaqësojnë ato të Universitetit Bujqësor të Tiranës.

Emër MBIEMËR

Tiranë, më data muaji viti

Dedikimi

Mirënjohje dhe falënderime

Mos i kurseni falënderimet dhe mirënjohjet. Është momenti t'i shprehni ato.

Abstrakti

Shkruhet në fund fare. Maksimumi 300 fjalë të strukturuar në jo më shumë se tre paragrafë.

A është përmbledhur gjithçka në pak fjalë?

Tabela e përmbajtjes

Autorësia	ii
Mirënjohje dhe falënderime	iv
Abstrakti.....	v
Pasqyra e objekteve	vii
Shkurtime dhe shpjegime	viii
KAPITULLI 1 HYRJE: PROBLEMATIKA E PËRGJITHSHME DHE FOKUSI I STUDIMIT	1
1.1 Sfondi i problemit	1
1.2 Problemi i kërkimit dhe pse studiohet kjo çështje?.....	1
1.3 Struktura e punimit	2
KAPITULLI 2 RISHIKIM MBI LITERATURËN E FUSHËS	3
2.1 Analiza e problemit sipas këndvështrimit të autorëve më të njohur	3
2.2 Disa autorë vendas që trajtojnë një tematikë të ngjashme	3
2.3 Analiza konceptuale dhe deduktimi i hipotezave	3
KAPITULLI 3 METODAT DHE PROCEDURAT	4
3.1 Përkufizimi i variablave	4
3.2 Të dhënat.....	4
3.3 Metoda e përdorur	4
KAPITULLI 4 REZULTATE DHE INTERPRETIME	5
4.1 Rezultatet e analizës	5
4.2 Interpretimi dhe diskutimi i rezultateve.....	5
KAPITULLI 5 PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	6
Bibliografia.....	7
Shtojca	8

Pasqyra e objekteve

Tabela

Tabela 1. Rezultatet e analizës (regresive, përshkruese, cilësore, etj.) – titulli i tabelës vendoset sipër tabelës.	5
--	---

Figura

Figura 1. Pema e problemit tuaj – titulli i figurave dhe grafikëve vendoset poshtë objektit.....	1
--	---

Shkurtime dhe shpjegime

SYMB Shpjegimi i shkurtimeve apo akronimit

RT Një rast tjetër.

Kapitulli 1

Hyrje: Problematika e përgjithshme dhe fokusi i studimit

1.1 Sfondi i problemit

Jepni informacion mbi sektorin/fushën.

Si paraqitet gjendja e problemit tuaj?

A mund të sillni ndonjë evidencë? A mund të sillni një statistikë përshkruese për problemin tuaj? Po ndonjë grafik apo tabelë?

Cilët janë dimensionet e problematikës ose faktorët që shkaktojnë problemin e përgjithshëm?




Figura 1. Pema e problemit tuaj – titulli i figurave dhe grafikëve vendoset poshtë objektit.

1.2 Problemi i kërkimit dhe pse studiohet kjo çështje

Cili është problemi juaj i kërkimit?

A është problemi i kërkimit me interes për kërkuesin?

A paraqitet një nevojë të ndjerë për një njohje më të mirë apo për të hedhur dritë mbi problemin e zgjedhur?

A sugjeron problemi i kërkimit hipoteza të logjikshme dhe të testueshme?

A është problemi i kërkimit mjaftueshëmrisht specifik dhe i menaxhueshëm?

Cili është justifikimi i ndërmarrjes së këtij kërkimi?

Cila është e reja që sjell kërkimi i ndërmarrë? Në çfarë konteksti shihet risia e këtij studimi: gjeografik, kontributit në teori, përmirësimin e metodës apo diçka tjetër?

Kujt i adresohet studimi? Cilët janë palët e interesuara për të?

1.3 Struktura e punimit

Cila është struktura e punimit? Si është organizuar ai?

Të prezantohen me dy-tre fjali kapitujt e punimit.

Kapitulli 2

Rishikim mbi literaturën e fushës

2.1 Analiza e problemit sipas këndvështrimit të autorëve më të njohur

Cila është teoria më e përshtatshme që trajton problemin e kërkimit?

Cilët janë autorët, të cilët kanë hedhur bazat për teorinë e këtij problemi? Si e trajtojnë ata problemin tuaj? Ku përqendrohen ata?

Çfarë mund të thuhet për rafinimin e kësaj teorie dhe ndihma e saj në qartësimin e problemit, formulimit të hipotezave dhe të metodës së përshtatshme për kontrollin e hipotezës?

A është kjo teori e konsoliduar?

2.2 Disa autorë vendas që trajtojnë një tematikë të ngjashme

Cilët janë disa nga autorët që kanë trajtuar një tematikë të ngjashme me tuajën?

Ku qëndron ngjashmëria e temës suaj me atë të atyre?

Cili është pozicioni i kërkimit tuaj në raport me to?

2.3 Analiza konceptuale dhe deduktimi i hipotezave

Mbështetur në analizën e problemit sipas të tjerëve, cila është lidhja mes koncepteve?

Cilat janë hipotezat që sugjerohen nga rishikimi i literaturës?

Kapitulli 3

Metodat dhe procedurat

3.1 Përkufizimi i variablave

Si propozohet të maten konceptet/variablat?

3.2 Të dhënat

Çfarë të dhënash keni: parësore apo dytësore?

Cila është natyra e të dhënave? Cili është burimi dhe sa është numri i tyre?

Nëse janë parësore, atëherë jepni informacion për pyetësin, përmasa e zgjedhjes dhe përfaqësueshmëria e saj.

3.3 Metoda e përdorur

Metoda nënkupton një model empirik, një analizë përshkuese, një parashikim, një metodë cilësore e të tjera.

Cila është metoda e përshtatshme për arritjen e objektivave dhe/ose për kontrollin e hipotezave?

A është e nevojshme përshtatja e saj me rastin në studim? Nëse po, cili është argumenti? A kontribuon ajo në arritjen e objektivit/testimin e hipotezës? Cilat janë dobësitë e saj?

Kapitulli 4

Rezultate dhe interpretime

4.1 Rezultatet e analizës

Çfarë thonë analizat tuaja lidhur me problemin?

Cilat janë gjetjet që rezultojnë prej tyre?

Tabela 1. Rezultatet e analizës (regresive, përshkruese, cilësore, etj.) – titulli i tabelës vendoset sipër tabelës.

Kolona 1	Kolona 2	Kolona 3	Kolona 4

4.2 Interpretimi dhe diskutimi i rezultateve

Si mund të interpretohen rezultatet e dala?

Si lidhen ato me njëri-tjetrin?

Si bëhen ato të kuptueshme për një audience të gjerë?

Këto rezultate, a e konfirmojnë pritshmërinë tuaj?

U arrit objektivi? Nëse keni hipotezë, a u kontrollua ajo?

Kapitulli 5

Përfundime dhe rekomandime

A bëhet mirë kalimi nga rezultate e këtij kërkimi në përgjithësimin teorik të tyre?

Cilat janë momentet e konvergencës dhe divergjencës me kërkimet e mëparshme? Çfarë mund të thuhet?

Cilat janë implikimet për aktorët publikë e privatë? Rekomandimet e studimit.

A ka vend për kërkime të mëtejshme?

Bibliografia

A është i qartë dallimi mes bibliografisë dhe referencave?

A bëhet dallimi midis citimit të drejtpërdrejt dhe atij të tërthortë? Po ndërmjet citimit dhe perifrimit?

Çfarë stili referimi është përdorur? A është shkruar ai në mënyrë korrekte?

Stili APA

Për një libër

Skreli, E. & Çera, G. (2013). *Metodologjia e kërkimit në ekonominë e zbatuar*. Tiranë: Maluka.

Për një artikull reviste shkencore

Çera, G., Çera, E. & Lito, G. (2013). A GARCH model approach to calculate the value at risk of Albanian lek exchange rate. *European Scientific Journal* 9(25), 191–226.

Për prezantimet në një konferencë shkencore

Gegprifti (Jonuzaj), A. & Çera, G. (2013). Are Political Budget Cycles Present in Albania? *Risk and its Assessment in Regional Economy. Proceedings of the Fifth International Conference for Risk* (p. 25-38). Ohrid, Macedonia: Albanian Center for Risk.

Për një burim nga interneti

Banka e Shqipërisë (a.d.). *Statistika: Bazë e të dhënave të serive kohore të Bankës së Shqipërisë*. Datë aksesi 14 prill 2013, në linjë:
http://www.bankofalbania.org/web/Serite_kohore_22_1.php?evn=agregate_detaje&evb=agregate&cregtab_id=662&periudha_id=3

Për një raport

Banka Botërore (2011). *Investing across borders 2010*. New York: World Bank Group.

Shtojca

Çfarë informacioni kërkoni të vendosni te shtojca?

A është ai i lidhur me pjesët e mësipërme?